



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË



RAPORT

I TREGUESVE TË PUNËS
TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË
PËR VITIN 2017

Tiranë, Shkurt 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË**

R A P O R T

**I TREGUESVE TË PUNËS TË
PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS
SË PARË TIRANË PËR VITIN 2017**

Tiranë, Shkurt 2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TIRANË**

E Nderuar Zj.Prokurore e Përgjithshme!

Të nderuar të ftuar, të nderuar kolegë!

Sot jemi mbledhur për të zhvilluar analizën e punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2017.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, gjatë këtij viti që po analizojmë, është përpjekur të ushtrojë ndjekjen penale dhe të përfaqësojë akuzën në gjykim, në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin penal, dhe në pajtim me prioritetet që ka shpallur Qeveria Shqiptare. Në këtë raport, do të trajtojmë veprimtarinë tonë njëvjeçare, për sa i përket treguesve sasiorë dhe cilësorë, evidentimin e praktikave dhe dukurive pozitive e negative, në mënyrë që për vitin në vazhdim, të bëhen korrigjimet përkatëse aty ku ka patur probleme si dhe të përmirësohet akoma më shumë puna në drejtim të atyre rasteve që vlerësohen pozitivë.

Gjate këtij viti, në përfaqësim të prioritetit të Qeverisë Shqiptare dhe të Prokurorisë, prokurorët kanë patur në fokusin e tyre kryesor, forcimin e luftës kundër kriminalitetit në tërësi, dhe veçanërisht kundër korrupsionit, narkotikëve, krimet kundër jetës etj. Njëkohësisht i është kushtuar vëmendje e posaçme, përmirësimit të cilësisë së hetimeve në tërësi, cilësisë së veprimeve hetimore, përdorimit efikas të mjeteve të kërkimit të provave, zhvillimit të hetimeve proaktive dhe koordinimit të hetimit proaktiv me atë klasik, në funksion të arritjes së një produkti sa më të mirë, për evidentimin e veprave penale dhe vënien para drejtësisë të personave përgjegjës.

Në të njëjtën kohë është treguar kujdes i veçantë si nga çdo prokuror ashtu edhe nga drejtuesi i prokurorisë, dhe drejtuesit e seksioneve, cilësisë së hartimit të akteve procedurale,


zbatimit rigoroz të rregullave procedurale në marrjen e provave, garantimin e të drejtave të personave të hetuar dhe të pandehur, kjo me qëllim shmangien në maksimum të pavlefshmërive që mund të kërkohen nga palët në gjykatë.

Në vitin që lamë pas, kjo zyrë Prokurorie përballoi një ngarkesë më të lartë se një vit më parë, përse i takon numrit të materialeve të shqyrtuara, kallzimeve të trajtuara dhe procedimeve penale të hetuara. Në këtë analizë do të trajtojmë në mënyrë të detajuar treguesit sasiorë dhe cilësorë të punës në tërësi të kësaj Prokurorie dhe të çdo prokurori në veçanti. Qëllimi kryesor i analizës është të evidentoj të gjitha momentet dhe dukuritë pozitive e të metat në punën tonë të një viti, në mënyrë që për vitin në vazhdim të bëhen korrigjimet përkatëse, aty ku janë hasur probleme dhe të përmirësohen akoma më shumë treguesit në ato raste që vlerësohen pozitivë.

Fillimisht do të trajtojmë në formë statistikore të gjitha të dhënat e evidentuara gjatë këtij viti, duke kaluar më pas në një analizë të thellë të tyre dhe të gjithë problemeve që janë hasur.

I. KALLËZIMET E REGJISTRUARA GJATË VITIT 2017


Gjatë këtij viti në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë janë regjistruar gjithsej **17321** kallzime penale. Kjo shifër është më e lartë se viti 2016, ku janë regjistruar **16558** kallzime. Në krahasim me një vit më parë, konstatohet se janë regjistruar **763** kallzime më shumë. Është ulur numri i kallzimeve të referuara nga policia ushtarake, ndërkohë është rritur numri i kallzimeve nga nëpunësit publikë, shtetasit, Policia e Shtetit dhe ato të regjistruara kryesisht.



Gjatë vitit 2017, kallëzimet kanë ardhur në përqindjen më të madhe nga Policia e Shtetit - **15250** kallëzime, **958** nga shtetasit; **726** nga nëpunësit publikë; 4 nga policia ushtarake, 18 proçedime janë filluar kryesisht.

Nr	Referuar nga Institucione ose shtetasit	Nr.i Kallzimeve	
		Viti 2016	Viti 2017
1	Policia e shtetit	15018	15250
2	Shtetasit	924	958
3	Nëpunësit publikë	584	726
4	Policia e ndërtimit	----	----
5	OSHEE	3	3
6	Policia pyjore	----	4
7	Filluar kryesisht	16	18
8	Policia ushtarake	13	4
	Gjithsej	16558	17321

Për të krijuar një ide më të qartë sa u përket referimeve tabela e mësipërme ilustron edhe nga grafiku vijues:




Edhe këtë vit, i është kushtuar vëmendje studimit dhe verifikimit të materialit kallzues, me qëllim evitimin e regjistrimeve të pabazuara të proçedimeve penale, shmangien e hetimeve të panevojshme, garantimin e të drejtave e lirive themelore të shtetasve dhe kostot e tepërta financiare të hetimeve. Për një pjesë të kallzimeve koha mesatare për kryerjen e verifikimeve ka qënë relativisht e gjatë. Një pengesë serioze ka qënë kryerja dhe administrimi në kohë i akteve të ekspertimit mjekoligjor. Në vlerësimin tonë, puna e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Drejtorisë së Policisë Shkencore në këtë drejtim, nuk ka qënë në nivelin e duhur duke sjellë si pasojë vonesa ne zgjidhjen e materialeve kallezuese.

Përveç kësaj, vonesa ka ardhur edhe nga një punë e pamjaftueshme e oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit të Prokurorisë, të cilët duhet të jenë më aktiv në rolin e tyre, në fazën e verifikimit të materialeve kallzuese.

Shkak tjetër për këtë është edhe ngarkesa e madhe e materialeve të reja që shqyrton secili prokuror. Ngarkesa mesatare vjetore e materialeve kallzuese për çdo prokuror, varion në rreth 280 materiale. Një ngarkesë e tillë është dukshëm mbi normalen dhe vetvetiu sjell edhe vonesa në përfundimin në kohë të tyre.

Në tabelën në vijim, paraqitet shpërndarja sipas veprave penale, për të gjitha rastet kur është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

Veprat penale të grupuara sipas krerëve	Nr. i mosfillim	
	2016	2017
Kr.I Krime K/Njerëzimit	---	1
Kr.II V.P K/Personit	2037	2043
Kr.III V.P K/Pasurisë dhe Ekonomi	2236	2918
Kr.IV V.P K/Mejdisit	25	21
Kr.V Krime K/Pavarës. R/K	---	1
Kr.VI Krime Cën/Marrdh.Shte	---	----
Kr.VII Akte Terroriste	4	1
Kr.VIII V.P K/Autorit.Shtetit	1490	1671
Kr.IX V.P K/Drejtësisë	95	135
Kr.X V.P Prekin. Zgjedh. e Lira	---	1
Kr.XI V.P Kryera nga Band. Arm	---	---
Vepra të tjera	505	760
TOTALI	6392	7552



Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se, rreth **27 %** të rasteve kur është vendosur mosfillimi i procedimit e përbëjnë referimet për veprat penale të parashikuara nga Kreu i II-të dhe rreth 38.6% përbëjnë referimet për veprat penale të parashikuara nga Kreu i III-të. Krahasuar me vitin 2016, numri i përgjithshëm i mosfillimeve është rritur me **1160**.

Vlen të analizojmë se, në këtë grup veprash penale në **598** raste mosfillimi është vendosur për veprën penale “Kanosja”, parashikuar nga neni 84 i K.Penal, në **591** raste për veprën penale “Dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90 i K.Penal dhe në **213** raste për veprën “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i K.Penal. Përsa i takon veprës penale të parashikuar nga neni 84 i K.Penal edhe këtë vit është patur parasysh në mënyrë rigoroze, kërkesa e ligjit material penal që kanosja të ketë qënë serioze dhe për çdo rast është kërkuar që ekzistenca e armës, apo të çdo objekti tjetër që mund të jetë përdorur, të jetë reale (të jenë sekuestruar) dhe jo hipotetike.

Nga të dhënat e mësipërme vihet re se, rastet e mosfillimit për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i K.Penal, përbëjnë **7.8%** të numrit të përgjithshëm të mosfillimeve, për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, përbëjnë **2.8%** të numrit të përgjithshëm të mosfillimeve dhe për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i K.Penal përbëjnë **8.0%**. Me fjalë të tjera, rreth **18.6%** e të gjithë mosfillimeve e përbëjnë rastet kur kallzimi është bërë për nenet 90 dhe 89 të Kodit Penal. Raste të tjera mosfillimi të veprave penale të këtij kreu, që nuk janë dhënë në mënyrë të detajuar më sipër kanë të bëjnë me rastet e vdekjeve natyrale, vetvrasjeve, etj.

Në krahasim me një vit më parë, është rritur numri i rasteve kur është vendosur mosfillimi i procedimit penal, përsa u takon veprave penale të parashikuara nga kreun e III, të Kodit Penal. Për këtë kre, numri i rasteve kur është vendosur mosfillimi i procedimit penal përbën rreth **38.6%** të numrit të përgjithshëm të mosfillimeve. Rritja e numrit të mosfillimeve, për sa i takon këtij grupi

veprash penale, shpjegohet me faktin se është rritur numri i rasteve për materialet kallzues në lidhje me këto vepra penale te referuara.

Në grupin e veprave të parashikuara në kreun e III-të, në **189** raste është vendosur mosfillimi për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”, parashikuar nga neni 186 i K.Penal dhe në **281** raste mosfillimi për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Po në këtë “kre” të Kodit Penal, është vendosur mosfillimi në **525** raste për veprën penale “Mashtrimi”, parashikuar nga neni 143 i K.Penal. Me fjalë të tjera, rreth **13.2%** e të gjithë mosfillimeve e përbëjnë rastet kur kallzimi është bërë për këta tre nene. Vendime të tilla janë marrë, pasi nga gjithë të dhënat ka rezultuar e qartë se ndodhemi përpara një marrëdhënie juridiko-civile dhe kallzuesit nuk i janë drejtuar Gjykatës për zgjidhjen e saj, por kanë konsideruar si zgjidhje më të lehtë e më me interes për ta, paraqitjen e kallzimit në Prokurori. Nuk mungojnë edhe rastet kur ndonëse kallzuesi ka bërë padi në Gjykatë, paralelisht duke menduar për një zgjidhje të shpejtë, apo me qëllim për të pezulluar gjykimin, bën kallzim edhe në Prokurori. Edhe gjatë këtij viti, të gjitha kallzimet e kësaj natyre janë trajtuar me shumë kujdes, për të shmangur çdo përfshirje të panevojshme të Prokurorisë në zgjidhjen e konflikteve civile midis palëve.

Në grupin e veprave të parashikuara në kreun e VIII-të, në **410** raste mosfillimi është vendosur për veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i K.Penal. Të gjitha materialet në lidhje me këtë veprë penale kanë qënë të referuara me persona në gjendje të lirë dhe shumicën e përbëjnë ato raste ku pasoja e ardhur nuk ka qënë ajo e parashikuar në dispozitën penale të këtij neni. Vendimet e mosfillimit të procedimeve penale kanë qënë të bazuara në aktet e administruara dhe kërkesat e ligjit procedural penal. Këtë e dëshmon edhe fakti që vetëm 8 vendime mosfillimi janë shfuqizuar nga gjykata, janë regjistruar dhe që të gjitha janë ende në hetim.

Veprat penale që lidhen me korrupsionin, pastrimin e parave, shpërdorimin e detyrës, kontrabandës dhe veprave penale në fushën e tatimeve, janë vepra sensitive dhe me impakt të gjerë në publik. Pavarësisht shifrave, në hetimin e këtyre veprave penale nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë është treguar përkushtimi dhe vëmendja maksimale. Të dhënat mbi to paraqiten si më poshtë;

Së pari, janë regjistruar kryesisht (me iniciativë të prokurorit) **18** procedime penale, krahasuar me 16 të një viti më parë. Jemi pothuaj në të njëjtat parametra të ushtrimit të ndjekjes penale kryesisht, si dhe përdorimit me qëllim gjenerimin e procedimeve penale duke përdorur të dhëna të marra nga burime të hapura publike, si dhe të dhëna me natyrë inteligjente.

Së dyti, janë regjistruar 6 referime të ardhura nga Kontrolli Lartë i Shtetit, nga keto në 3 raste është vendosur regjistrimi (dy janë ende në hetim dhe një çështje është pushuar) i procedimeve penale, në 3 raste është vendosur mosfillimi.

Së treti, mbi bazën e materialeve të referuara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave gjatë vitit 2017, janë regjistruar 13 procedime penale, ku 12 procedime penale janë ende në hetim dhe një është transferuar. Në një krahasim me vitin e kaluar jemi në të njëjtat parametra ka të bëjë me veprën penale të kontrabandës nga ana e subjekteve tregtare dhe në asnjë rast nuk ka patur referime për kontrabandë të kryer nga punonjësit e administratës doganore.

Së katërti, përsa i takon referimeve të ardhura nga ana e Drejtorisë së Hetimit Tatimor gjatë vitit 2017, janë rregjistruar rreth 38 (50 në vitin 2016) procedime penale dhe janë mosfilluar dy referime të ardhura nga ky institucion. Nga këto 3 procedime penale janë pushuar, 7 janë dërguar për gjykim dhe 28 procedime penale janë ende në hetim.

Krahasuar me 2016 ku janë regjistruar 50 procedime mbi referimin e administratës tatimore, për këtë vit vërehet rënie e referimeve nga Drejtoria e Hetimit Tatimor.

Së pesti, mbi bazën e materialeve të referuara nga ana e ILDKP-së gjatë vitit 2016 janë referuar gjithsej 7 (17-2016) kallzime penale, nga ku janë regjistruar 7 (13-2016) procedime, të cilat dy janë dërguar për gjykim dhe 5 janë ende në hetim. Këtë vitë numri i materialeve të referuara është më i ulët se një vit më parë, ndërkohë që është vazhduar t'i jepet rëndësi rritjes së cilësisë dhe plotësimit të tyre me të dhënat e nevojshme në funksion të çështjes penale.

Së gjashti, mbi bazën e materialeve të referuara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit gjatë vitit 2017, janë rregjistruar gjithsej **62** referime penale, krahasuar me **42** procedime penale të një viti më parë. Nga këto referime **9** janë mosfilluar, **1** është pushuar, **13** janë pezulluar, **1** është transferuar dhe **38** janë ende në hetim

II. USHTRIMI I NDJEKJES PENALE NË HETIM

Gjatë vitit 2017 janë hetuar gjithsej **12884** procedime penale me **6448** persona të pandehur dhe nën hetim, nga të cilët **903** me masë shtrënguese arrest (në burg, në burg me afat dhe në shtëpi) dhe pjesa tjetër e tyre me masa të tjera sigurimi dhe në gjendje të lirë. Në numrin e përgjithshëm të procedimeve të hetuara, **2322** prej tyre kanë qënë të mbartura nga viti 2016, **10265** procedime penale janë regjistruar rishtazi, ku për **147** procedime penale janë rifilluar hetimet dhe **150** procedime penale kanë ardhur për kompetencë nga Prokuroritë e tjera.

Të dhënat e përgjithshme përsa i takon proçedimeve penale dhe personave nën hetim paraqiten në tabelën në vijim:

EMËRTIMI	ÇËSHTJE		PERSONA NE HETIM		PANDEHUR		ARREST	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
TË MBARTURA	2398	2322	345	448	1036	870	289	258
TË REGJISTRUARA	9942	10265	1719	1985	3033	2970	882	615
RIFILLUAR	198	147	25	22	46	23	11	8
ARDH.KOMPETE	153	150	47	61	93	69	20	22
GJITHSEJ	12691	12884	2136	2516	4208	3932	1202	903

II.1 PËRFUNDIMI I ÇËSHTJEVE PËR VITIN 2017

Tabela në vijim, paraqet në mënyrë të përmbledhur të dhënat për mënyrën e përfundimit të proçedimeve penale gjatë hetimeve paraprake, si dhe numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim.

	Mënyra e Përfundimit							
	Nr.Proçedime penale		Nr. i personave në hetim		Nr. i të Pandehurve		Nr.Personave në gjendje arresti	
	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
Gjyqit	3649	3435			3912	3921	1089	815
Pezulluar	4746	4022			---	---	---	---
Pushuar	1577	1935	1020	1142	---	---	42	46
Transferuar	266	228	201	165	---	---	6	22
Gjithsej përf	10238	9620	1221	1307	3912	3921	1137	883
Hetim	2453	3264	915	1209	----	---	65	20


Nga të dhënat e tabelës së mësipërme evidentohet se, **3435** proçedime janë dërguar për gjykim me **3921** persona të pandehur, nga të cilët: **815** me masë sigurimi arrest dhe **3106** me masa të tjera sigurimi dhe në gjendje të lirë. Nga këta **655** proçedime janë dërguar për gjykim çështje të veprave penale kundër personit, **1704** për veprat penale kundër pasurisë, **1231** kundër autoritetit të shtetit, dhe **58** në fushën kundër drejtësisë. Janë pezulluar **4746** proçedime penale, dërguar për kompetencë **266** proçedime me **94** persona nën hetim. Janë pushuar **1577** proçedime me **1020** persona nën hetim nga të cilët **11** persona me masë sigurimi “arrest në burg” dhe **13** me masë sigurimi “Arrest në shtëpi”, dhe **978** persona me masa të tjera sigurimi dhe në gjendje të lirë. Për vitin 2017 janë mbartur **2453** proçedime me **915** persona në hetim, nga të cilët **65** persona janë me masë sigurimi “arrest në burg”.

Në tabelën vijuese paraqitet shpërndarja e proçedimeve penale të regjistruara sipas veprave penale të grupuara në krerët e Kodit Penal dhe mënyra e tyre e përfundimit.


Veprat penale të grupuara sipas krerëve	Nr. Proc.	Mënyra e Përfundimit				
		Gjyqit	Pushuar	Pezulluar	Komp.	Hetim
Kr.II V.P K/Personit	1390	541	359	90	23	377
Kr.III V.P K/Pasurisë dhe Ekonomi	7569	1302	689	3666	78	1834
Kr.IV V.P K/Mejdisit	32	8	5	12	-	7
Kr.V Krime K/Pavarës. R/K	1	-	1	-	1	-
Kr.VI Krime Cën/Marrdh.Shte	-	-	-	-	-	-
Kr.VII Akte Terroriste	4	-	1	2	-	1
Kr.VIII V.P K/Autorit.Shtetit	3701	1531	826	247	123	974
Kr.IX V.P K/Drejtësisë	159	49	52	5	3	50
Kr.X V.P Prekin. Zgjedh. e Lira	27	4	2	-	-	21
Vepra të tjera	-	-	-	-	-	-
TOTALI	12884	3435	1835	4022	228	3264

Sikurse shihet nga të dhënat e mësipërme, pjesën më të madhe e zënë proçedimet penale për veprat penale kundër pasurisë, kundër autoritetit të shtetit dhe kundër personit. Për këtë grup proçedimesh penale, treguesit më pozitivë janë ato në lidhje me veprat penale të parashikuara në Kreun II dhe VIII-të, mbasi për veprat penale të parashikuara në Kreun III, numri i proçedimeve penale të pezulluara është relativisht i madh.

Veprat penale që lidhen me pronën kanë njohur ulje. Janë regjistruar në total **7569** proçedime penale, që përbëjnë **431** proçedime penale më pak krahasuar me vitin 2016, veprat penale kundër kundër autoritetit të shtetit janë shtuar dhe janë regjistruar rreth **413** proçedime më tepër se një vit më parë. Po kështu edhe veprat penale kundër personit, ku janë regjistruar **141** proçedime më tepër.



Grafiku vijues ilustron për vitet 2016 dhe 2017 proçedimet penale të regjistruara rishtazi dhe të mbartura nga vitet përkatëse:



Gjatë kësaj periudhe, për hetimet paraprake është vendosur zgjatja e afatit të hetimit deri në tre muaj në **207** proçedime për 333 persona nën hetim, (prej të cilëve 89 kanë qenë me masë sigurimi arrest në burg); deri në gjashtë muaj në 72 proçedime për 135 persona nën hetim (prej të cilëve 31 kanë qenë me arrest në burg); deri në nëntë muaj në 26 proçedime për 51 persona nën hetim (prej të cilëve 7 kanë qenë me arrest në burg); dhe deri në **12** muaj në 4 proçedime për 10 persona nën hetim (prej të cilëve 4 kanë qenë me masë sigurimi arrest në burg).

Në krahasim me një vit më parë konstatohet se është rritur numri i çështjeve me zgjatje afati deri në tre muaj dhe jemi pothuajse në të njëjtat parametra me zgjatjet e tjera ku është ulur numri i zgjatjeve të afateve mbi deri në 12 muaj. Përgjithësisht zgjatjet e afatit të hetimit kanë qënë të motivuara dhe janë vendosur në ato raste kur hetimet kanë qënë komplekse. Megjithatë, numri i zgjatjeve të afatit do të ishte më i ulët, në rast se strukturat e hetimit të shërbimeve të policisë gjyqësore në Drejtorinë Rajonale Vendore Tiranë dhe strukturave në varësi të saj, do të ishin më të impenuara në kryerjen në kohë të veprimeve të deleguara nga prokurorët.

Në tabelën në vijim, paraqiten të dhëna të detajuara për vepra penale të caktuara sipas tabelës vijuese:

Neni	Nr Procedimi	Pandeh Ne hetim	Gjyqit			Pushuar			Pezulluar	Kopetenc		Gjithsej Përf		Në Hetim	
			Proc	Pandehur	Zyrtar	Proc	Pandehur	Zyrtar		Proc	Pand	Proc	Pan	Proc	Pan
137	365	252	181	183	-	26	23	-	62	-	-	269	206	96	46
174	42	18	4	5	-	6	9	-	3	6	3	19	17	23	1
175	1	1	-	-	-	-	-	-	-	1	1-	1	5	-	-
177	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
178	16	15	5	6	4	5	-	-	-	-	-	9	11	7	4
180	100	62	24	35	-	27	10	-	-	-	-	51	45	49	17
181	20	6	6	6	-	3	-	-	-	-	-	9	6	11	-
181/a	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
183	28	15	7	9	-	2	1	-	11	-	-	20	10	8	5
199/a	514	343	189	200	-	124	66	-	3	-	-	316	266	198	77
244	26	29	22	24	-	2	5	-	-	-	-	24	29	2	-
245/1	19	19	3	7	-	7	8	-	1	2	2	13	17	6	2
248	331	91	13	32	-	164	54	-	7	6	-	190	86	141	5
256	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
258	9	-	-	-	-	2	-	-	-	-	-	23	-	7	-
259	32	21	6	9	-	11	8	-	-	-	-	17	17	15	4
287	122	28	3	9	-	32	9	-	14	7	11	51	19	66	9
291	1153	1152	956	960	-	32	33	-	2	-	-	990	993	163	159
312	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Për këtë grup veprash, në krahasim me një vit më parë mund të konstatohet një ulje e numrit të procedimeve penale që janë regjistruar për veprën penale “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, “Fshehjes së të ardhurave”, ndërkohë që vërehet rritje e numrit të

procedimeve penale që janë rregjistruar për veprat penale të “Ndërtimi i paligjshëm”, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Drejtimi i mjeteve në mënyrë të parregullt”. Përsa i përket veprës penale të “Shpërdorimi i detyrës” numri i procedimeve penale është pothuaj i njëjtë, por vihet re që është ulur numri i çështjeve të dërguara për gjykim dhe është rritur numri i çështjeve të pushuara (gjë që vë në dukje cilësinë në rënie të referimeve të veprave penale). Dhe vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale” është pothuaj në të njëjtat shifra si në vitet e kaluara. Numri i procedimeve penale për veprat e tjera është pak a shumë në të njëjtat parametra.

II.2 PROCEDIME PENALE TË PUSHUARA

Në tabelën në vijim, paraqiten në mënyrë të përmbledhur procedimet penale të pushuara, gjendja e masës së sigurimit për personat nën hetim apo të pandehur, si dhe shkaqet pse është vendosur pushimi.

Nr.Proç	Persona	Arrest	Pushuar akuza					
			M.Fakti		M.Prove		Të tjera	
			Çështje	Persona	Çështje	Persona	Çështje	Persona
1935	1142	16 arrest burg 13 arrest shtëpi	1145	637	140	185	650	320

N.q.s i bëjmë një analizë shkaqeve për të cilat është vendosur pushimi i çështjes, konstatojmë se ne **1145** raste është vendosur pushimi i çështjes për mungesë fakti, në **140** raste është vendosur pushimi për mungesë provash.

Nga 1935 procedime penale të pushuara, në 415 prej tyre nga ana e prokurorit në bazë të ndryshimeve të K.Pr. Penale është bërë kërkesë në gjykatë për pushimin e procedimit penal (në numrin total të pushimeve janë llogaritur dhe ato kërkesa për pushim ku ende nuk ka vendimmarrje nga gjykata) dhe në 1520 procedime penale është vendosur pushimi nga prokurori.

Pushimet e procedimeve penale të sipërcituara i përkasin atyre rasteve të regjistruara kryesisht arreste në kushte flagrante dhe pas administrimit të akteve është konstatuar se nuk plotësohen elementët e veprës penale, rastet kur hetimet janë pushuar për shkak se fakti nuk ekziston, veç të tjerash janë edhe ato raste kur janë kryer hetime proaktive dhe me gjithë veprimet procedurale të kryera nuk është evidentuar ekzistenca e faktit kriminal, etj. Në këtë grup procedimesh përfshihen edhe ato raste kur nga ana e Gjykatës ka qenë vendosur shfuqizimi i vendimit të mosfillimit të prokurorit, duke urdhëruar këtë të fundit për të regjistruar procedimin penal. Vlerësojmë se numri i procedimeve penale të pushuara për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale apo se fakti nuk ekziston, mund të ishte edhe më i vogël, por ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale ku në nenin 291/1 përcaktohet afati 15 ditor në vendimmarrjen për mosfillimin e çështjes. Kjo ka bërë që prokurorët të regjistrojnë procedime penale pa u administruar aktet e nevojshme të ekspertimeve (pasi aktet e ekspertimit kryhen me shumë vonesë), të cilat do të përcaktonin nëse materiali kallzues duhet të mosfillohet apo të regjistrohet.

Në **650** raste është vendosur pushimi, mbasi ka qenë proceduar për vepra penale për të cilat aplikohet neni 284 i K.Pr.Penale dhe të dëmtuarit kanë hequr dorë nga ankimi; raste kur vepra penale është parashkruar, etj.

Vlen për tu theksuar se gjatë vitit 2017 janë rifilluar dhe është vendosur pushimi për parashkrim të ndjekjes penale nga ana e gjykatës për 321 procedime penale, dhe është vendosur nga ana e prokurorit pushimi për parashkrim të ndjekjes penale për 561 procedime. Në shumicën e rasteve u përkasin procedimeve penale me sanksion penal të ulët denimi si vjedhje e pasurisë paragrafi i parë, kanosje, etj.

Në numrin prej **1935** procedime penale të pushuara, është vendosur pushimi nga prokurori apo gjykata (me ndryshimet e fundit të K.Pr.Penale) për **28** persona me masë sigurimi arrest në shtëpi apo në burg. Në vlerë absolute ky numër është më i lartë se një vit më parë (4 persona). Për

vitin 2017 ky tregues është **1.5%** dhe për vitin 2016 ka qënë **1.5%**, pra jemi në të njëtat parametra si një vit më parë. Nga ana e prokurorëve është bërë një punë e vëmendshme në studimin e materialeve hetimore paraprake dhe një kujdes i madh në kërkesat për caktimin e masave të sigurimit. Nga analiza e proçedimeve për të cilat është vendosur pushimi i çështjes penale, është vlerësuar se vendimi i pushimit ka qënë i bazuar në kërkesat e ligjit dhe është marrë mbasi janë kryer të gjitha veprimet e duhura hetimore. Përsa u takon shkaqeve që kanë çuar në marrjen e vendimit të pushimit kur personat kanë qënë me masë sigurimi “arrest në burg”, në çdo rast ato janë analizuar me kujdes nga prokurori. Kjo analizë, është bërë me qëllim për të përcaktuar se çfarë kushtesh kanë ndryshuar që nga momenti i caktimit të masës së sigurimit dhe nëse këto kushte, kanë ndryshuar për shkak të hetimeve jo të plota apo të faktorëve të tjerë të cilët nuk ka qënë e mundur që të evidentoheshin dhe vlerësoheshin nga ana e prokurorit në momentin e caktimit të masës së sigurimit.

Numri i ulët i proçedimeve penale të pushuara, i cili vjen çdo vit në ulje, ku të pandehurit ose personat nën hetim kanë qënë në gjëndje arresti, tregon se ka vazhduar t’i kushtohet një vëmendje e madhe vlerësimit të provave që në momentin e caktimit të masës së sigurimit, me gjithë problemet që u evidentuan më sipër. Në konkluzion, për vitin 2017 është e nevojshme që të bëhet edhe më shumë kujdes përsa i takon momentit të caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, duke u kujdesuar që “arrest në burg”, të jetë vërtet një masë përjashtimore dhe të caktohet në ato raste kur vlerësohet që masat e tjera janë të papërshtatshme.

II.3 PROCEDIME PENALE ME HETIME PROAKTIVE

Gjatë vitit 2017, janë regjistruar gjithsej 76 proçedime penale me hetime proaktive, të cilat i takojnë të gjitha linjave të prokurorisë. Këto proçedime penale janë regjistruar për veprat penale si: shpërdorimi i detyrës, korrupsionit pasiv, veprat penale në fushën e drogës, vrasje, pastrimit të parave etj. Duhet nënvizuar se nga ana e prokurorëve i është dhënë rëndësia e duhur aplikimit të metodave speciale të hetimit, si mënyrë shumë e rëndësishme dhe në shumë raste e vetme, për të siguruar mbledhjen e provave të mjaftueshme për provueshmërinë e akuzës. Por gjithmonë, është treguar kujdesi i duhur në momentin e regjistrimit me qëllim që të administrohet një bazë sa më e plotë e të dhënave.

II.4 VEPRA PENALE TË RËNDA TË HETUARA NË VITIN 2017

Gjatë këtij viti janë hetuar **649** proçedime penale për vepra penale të rënda si vrasje me dashje, vrasje me paramendim, vrasje në rrethana të cilësuar, plagosje të rëndë, shfrytëzim prostitucioni, prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike, vjedhje me armë, vjedhje me pasojë vdekjen, etj., me **745** persona të pandehur/nën hetim, nga të cilët **220** me masë sigurimi “arrest në burg”.

Përsa i takon mënyrës së përfundimit të tyre evidentohet se, **195** proçedime penale janë dërguar për gjykim, **204** janë pushuar, **53** janë pezulluar dhe për **9** është shpallur moskompetenca. Treguesit sasiorë për veprat penale të rënda, janë pak më të ulta se viti 2016 dhe konkretisht me **11** proçedime penale më pak, por janë më shumë dosje të dërguara për gjykim, rreth **75** procedime penale më shumë me **166** persona nën hetim më shumë. Ka më pak procedime penale të pushuara, **89** procedime penale më pak.

Në mënyrë më të detajuar, shpërndarja e proçedimeve penale sipas veprave penale të rënda dhe mënyra e përfundimit të tyre, paraqitet në tabelën në vijim:

Akuza	Nr.Proc	Pandehur + ne hetim	Arrest	Mënyra përfundimit				
				Gjyqit	Pushuar	Pezull	Mosk	Hetim
76	26	19	4	3	4	6	-	13
78	19	7	3	2	-	5	1	11
79	8	5	1	1	-	1	1	5
88	26	28	1	12	5	3	-	6
100	7	6	4	3	-	2	-	2
101	4	2	-	-	1	-	1	2
114	26	21	12	5	4	2	1	14
140	12	8	6	2	2	4	1	3
141	2	1	-	-	1	1	-	-
283	529	643	180	167	187	29	4	154
Gjith	649	745	220	195	204	53	9	210

II.5 DOSJET E RIFILLUARA NE VITIN 2017

Tabela në vijim paraqet të dhënat për procedimet penale për të cilat është vendosur rifillimi i hetimeve, si dhe mënyrën se si është proceduar më tej me to.

Rifilluar			Gjyqit			Pushuar				Pezull	Transf	Në hetim		
Çësh	Pande dhe ne hetim		Çësh	Pande dhe ne hetim		Çësh	N.66.kp	Pande dhe ne hetim				Çësh	Pand	
	A	Lirë		A	Lirë			A	Lirë	A	Lirë			
147	8	37	19	6	13	39	-	1	11	60	6	24	0	5

Në bashkëpunim me shërbimet e policisë gjyqësore, i është kushtuar një vëmendje e veçantë analizës së dosjeve të pezulluara, me qëllim që të kryheshin veprime të tjera hetimore për zbulimin e autorëve të veprave penale. Për rrjedhojë, këtë viti janë rifilluar hetimet në **147** procedime penale, prej të cilëve **19** procedime janë dërguar për gjykim me **19** të pandehur. Në **39** raste është vendosur pushimi i çështjes dhe në **60** raste hetimet janë pezulluar përsëri. Në hetim ndodhen ende **24** procedime penale me **5** persona në hetim në gjendje të lirë.

II.6 MASAT E SIGURIMIT PERSONAL NË VITIN 2017

Edhe gjatë këtij viti është synuar që në një shumicë rastesh të aplikohen masa sigurimi të ndryshme nga ajo e “arrestit në burg”, duke mos e konsideruar këtë si një “zbutje” të qëndrimit të prokurorit, por duke i qëndruar korrekt kritereve për caktimin e masave të sigurimit personal. Në momentin e caktimit të masave të sigurimit është patur veçanërisht në konsideratë vlera që ka masa e sigurimit për fazën e hetimeve paraprake dhe jo mentaliteti që e lidh detyrimisht aplikimin e dënimit me burgim, me llojin e masës së sigurimit.


Gjithmonë është patur parasysh që lloji i masës së sigurimit të caktuar nuk përcakton për asnjë çast masën e dënimit që do të kërkohet nga prokurori dhe do të caktohet më tej nga Gjykata ndaj të pandehurit në rastin kur ai gjendet fajtor për veprën penale. Megjithatë, në një pjesë rastesh, masat e sigurimit të caktuara nga ana e Gjykatës kanë qenë më të buta se ato të kërkuara nga ana e prokurorit.

Këtë vit mund të përmendim rastet e aplikimit nga ana e gjykatës të masës së sigurimit të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale pa respektuar kriteret ligjore për këtë masë sigurimi, ndërkohë që nga ana e prokurorisë është vazhduar t’i kushtohet vëmendje, aplikimit sa më pak të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi” ku konstatohet se numri i kërkesave të tilla është **14** më shumë se viti 2016.

Treguesit për masat e sigurimit të kërkuara nga prokurori dhe atyre të vendosura nga ana e Gjykatës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Kërkesa e prokurorit											
A.Burg		A.Bu.afat		A.Shtëpi		Gar.pas.		Det.p.para		Pez.usht.	
2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
1403	912	36	45	39	53	4	2	279	279	-	-
Vendimi i gjykatës											
A.Burg		A.Bu.afat		A.Shtëpi		Gar.pas.		Det.p.para		Pez.usht.	
2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017
1114	798	25	23	173	132	4	2	445	598	-	-
+289	+114	+11	+22	-134	-79	-	-	-166	-319	-	-

Për të krijuar një perceptim vizual të diferencës, të dhënat e mësipërm paraqiten edhe në formën grafike si më poshtë:



Krahasuar me vitin 2016 rezulton se, nga ana e prokurorisë ka patur **491** kërkesa më pak për caktim mase sigurimi arrest në burg. Numri i masave të sigurimit “arrest në burg” të kërkuara nga prokurori është **114** më tepër se sa ato që janë caktuar nga ana e gjykatës. Ndërkohë që Gjykata ka caktuar masë sigurimi “arrest në shtëpi” në **79** raste më tepër se sa ka kërkuar prokurori.

Në 153 raste nga ana e prokurorit është bërë apel kundër vendimit të gjykatës për caktimin e masës së sigurimit. Nuk është bërë apel në ato raste kur, në seancën e vlerësimit të arrestit dhe të caktimit të masës së sigurimit janë paraqitur rrethana të reja që lidhen me normalizimin e marrëdhënieve mes palëve, në lidhje me personalitetin e të dyshuarve dhe sidomos në lidhje me angazhime në shkolla etj. të cilat nuk dihen në kohën e përpilimit të kërkesave nga prokuroria. Nga ana e prokurorit të Apelit është hequr dorë nga ankimi në 63 raste, janë shqyrtuar nga Gjykata e Apelit në 90 raste dhe në 38 raste Gjykata e Apelit i ka dhënë të drejtë apelit të prokurorit.


Gjatë vitit 2017, në 2 (12 në vitin 2016) raste është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i të arrestuarit mbasi arrestimet ishin bërë në kundërshtim me kërkesat e ligjit.

II. 7 TREGUESIT KRYESOR TË KRAHASUAR ME VITIN 2016

Në mënyrë të përmbledhur treguesit kryesorë të hetimit për vitet 2016 dhe 2017 paraqiten në tabelën në vijim:

Viti	Nr.pr.pen.	Gjyqit	Pushuar	Pezull	Transf	Hetim	Nr.mosf
2016	12691	3649	1577	4746	266	2453	6392
2017	12884	3435	1935	4022	228	3264	7552
Diferenca	+193	-214	+358	-724	-38	+811	+1160

Me qëllim perceptimin vizual të të dhënave krahasuese tabela e mësipërme paraqitet dhe me grafikun si më poshtë:



Siç rezulton nga shifrat, gjatë këtij viti në krahasim me një vit më parë, numri i përgjithshëm i procedimeve penale të hetuara, se bashku me numrin materialeve të referuara është më i lartë. Konkretisht për vitin 2017 janë hetuar **193** procedime më tepër krahasuar me 2016. Nderkohe janë dërguar për gjykim **214** procedime penale më pak në krahasim me vitin e kaluar, janë pushuar **358** procedime penale me shumë, janë pezulluar **724** procedime penale më pak dhe janë mosfilluar **1160** çështje më shumë. Në tërësi është përballuar një ngarkesë pune më e lartë se një vit më parë.

Nga të dhënat vihet re se janë mbartur në hetim nga viti 2017 në vitin 2018, 811 procedime penale më shumë se ato të mbartura nga viti 2016 në vitin 2017. Ngarkesa e punës së kësaj prokurorie ka ardhur në rritje progresive dhe tregon që ritmi i punës së prokurorëve dhe o.p.gj.-ve, në kushtet e kësaj ngarkese gjithnjë e në rritje, është i lartë, megjithëse gjithmonë ka vend për përmirësime të metejshme.

Në një analizë të të dhënave të mësipërme krahasuar me ato të vitit 2016, konstatohet se, është ulur numri i procedimeve penale të dërguara për gjykim dhe atyre të pezulluara dhe është rritur numri i vendimeve të mosfillimit dhe numri i procedimeve penale të pushuara. Këto shifra tregojnë dukshëm për rritje të materialeve kallzuese të referuara pa elementë të veprës penale. Duhet treguar kujdes më i madh nga të gjithë aktorët (prokurorë dhe vecanërisht policia gjyqësore) në mbledhjen e provave si edhe kryerjen e veprimeve nga ana e policisë për zbulimin e autorëve të veprave penale.

Gjithsesi dhe për vitin në vijim do të bëjmë përpjekje maksimale për përmirësimin e treguesve të punës.

III.1 PROCEDIME PENALE TË GJYKUARA

Tabela në vijim, paraqet treguesit për gjithë procedimet penale të gjykuara në periudhën objekt analize. Në këtë tabelë paraqiten të dhëna edhe lidhur me llojin e gjykimit, kërkesat e prokurorit për masën e dënimit, rastet e tërheqjes së akteve ose akuzës, si dhe numri i apeliimeve që u është bërë vendimit të gjykatës.

Nr.procedim		Numri i te pandehurve						Lloji Gjykimit						Ankime	
		Arrest		Masa te tjera sig. e te lire		Gjithsej		Zakonsh		Shkurtuar		Dpd			
2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	2016	2017	'16	'17	'16	'17
3645	3016	849	808	3335	2611	4184	3419	434	203	3729	2795	16	11	641	291

Gjatë vitit 2017, janë përfunduar gjykimet për **3016** procedime penale me **3419** të pandehur, nga të cilët **808** me masë sigurimi “arrest në burg” dhe **2611** me masa të tjera sigurimi dhe në gjëndje të lirë. Në lidhje me mënyrën e zhvillimit të gjykimit vihet re se, në **203** raste është proceduar me gjykim të zakonshëm; në **2795** raste me gjykim të shkurtuar dhe në **11** raste me gjykim të drejtpërdrejtë. Nga ana e prokurorëve është nxjerrë për 37 të pandehur ku në një rast është refuzuar nga gjykata. Përsa i përket gjykimit me marrëveshje është nënshkruar marrëveshja me 218 të pandehur dhe 12 prej tyre janë refuzuar nga gjykata.

Nga numri i përgjithshëm i të pandehurve që janë gjykuar në kërkesat përfundimtare prokurori ka kërkuar, dënim me burgim për 1495 të pandehur, pezullim ekzekutimi vendimi për 1257 të pandehur, dënim me gjobë për 285 të pandehur, detyrim për kryerjen e një pune në interes publik për 167 të pandehur dhe masa mjekësore për 41 të pandehur. Në 161 raste prokurori ka kërkuar pushimin e çështjes ose të gjykimit dhe në 1 rast ka kërkuar tërheqjen e akteve.


Ndërkohë që Gjykata ka vendosur, dënim me burgim për **1191** të pandehur, pezullim ekzekutimi vendimi për **1283** të pandehur, dënim me gjobë për **331** të pandehur, detyrim për kryerjen e një pune në interes publik për **272** të pandehur, pushim të gjykimit dhe çështjes për **207** të pandehur, masa mjekësore për **41** të pandehur dhe pafajësi për **86** të pandehur.

Në **291** (641 në vitin 2016) raste, prokurori nuk ka qënë dakort me vendimin e Gjykatës dhe ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit. 82 ankime janë bërë në lidhje me vendimet e pafajësisë, 84 në lidhje me dënimet me kusht dhe 125 për lloj dhe masë dënimi.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të përmblodhur, të dhëna lidhur me kërkesat e prokurorit në lidhje me masën dhe llojin dënimit, si dhe vendimet respektive të dhëna nga Gjykata.

Kërkesa e prokurorit								
Burg	Kusht	Gjobë	N. 63 K.P	M.Mjek	M.Edu	P.Gjyk	P.Çësh	T.Akte
1495	1257	285	167	41	-	161	-	1
Vendimi i Gjykatës								
Burg	Kusht	Gjobë	N. 63 K.P	M.Mjek	M.Edu	P.Gjyk	P.Çësh	Pafajsi
1191	1283	331	272	41	-	207	-	86
+304	-26	-46	-105	-	-	-46	-	

Me qëllim perceptimin vizual të tabelës së mësipërme dhe diferenca, të dhënat paraqiten edhe në grafikun vijues:



Treguesit e mësipërm, flasin qartë që edhe për këtë vit politika e dënimit e kërkuar nga prokurori është më e ashpër se sa dënimet që janë dhënë nga ana e Gjykatës. Në **304** raste më tepër është kërkuar nga prokurori dënim me burgim, në **26** raste më tepër Gjykata ka aplikuar pezullimin e dënimit dhe në 101 rastë më shumë ka vendosur aplikimin e nenit 63 të K.Penal. Politika e dënimit përsa i takon veprave të rënda dhe sensitive, veçanërisht kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, kultivimit dhe mbajtjes së lëndëve narkotike, drejtimit i mjeteve në mënyrë të parregullt, vjedhje e energjisë elektrike, ndërtimi i paligjshëm, pastrimit të parave, vrasjeve, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, vjedhjes së pasurisë, etj. ka qenë e ashpër dhe në përputhje me rrezikshmërinë e tyre, shkallën e përhapjes, si dhe rëndësinë përsa i përket ndjeshmërisë publike.

III.2 PROCEDIME PENALE TË RËNDA TË GJYKUARA

Gjatë këtij viti ka përfunduar gjykimi për **173** procedime penale për krime të rënda, me **236** persona të pandehur nga të cilët **146** të pandehur me masë sigurimi “arrest në burg”. Për **149** persona të pandehur nga ana e gjykatës është dhënë dënimi me burgim dhe apeli është ushtruar në **43** raste. Janë deklaruar të pafajshëm **7** të pandehur.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhëna në lidhje me procedimet penale të gjykuara, për një grup veprash penale të rënda.

Akuza	Nr. Çështje	Të pandehur		Lloji i gjykimit			Lloji i dënimit					Pafajësi	Apel
		Pan	Arr	Za.	Shk.	D.	Burg	Gj	Ku	M.M	P.gj		
76	10	11	6	1	9		7	-	-	-	3	-	3
78	2	2	2	1	1		1					1	1
79	2	3	3	2	1		3	-	-	-	-	-	2
88	12	17	6	6	11		9	-	6	2	-	-	2
114	7	15	8	2	13		9	2	3	-	1	-	-
140	2	2	2	1	1		2	-	-	-	-	-	1
283	138	186	119	25	158		118	-	55	-	6	6	33
Tot.	173	236	146	38	194		149	-	64	2	10	7	43

III.3 TREGUESIT KRYESOR TË PROCEDIMEVE TË GJYKUARA **KRAHASUAR ME VITIN 2016**

Në tabelën në vijim, janë pasqyruar treguesit sasiorë të gjykimit për vitet 2016 dhe 2017, të cilat konsistojnë në numrin e çështjeve të gjykuara, numrin e të pandehurve, masat e sigurimit të të pandehurve, llojin e gjykimit të zhvilluar, kërkesat e prokurorëve në lidhje me masën e dënimit, si dhe numrin e apeliemeve të vendimit të Gjykatës.

Nr.Procedimi		Nr. Pandehurve			Lloji Gjykimit			Lloji Dënimit						Ankime
		A	L	Gj	Za	Shk	Dp	B	Gj	K	Pun. det.	M.m	Paf ajes i	
V. 2016	3642	845	3335	4180	433	3727	16	1711	549	1424	250	33	116	639
V. 2017	3035	827	2619	3446	259	3160	12	1191	335	1293	272	41	86	291
Diferenc	-607	-18	-716	-734	-174	-567	-4	-520	-214	-131	+22	+8	-30	-348

Në një analizë të të dhënave të mësipërme në lidhje me politikën penale të prokurorit për vitin 2017, në vlerë absolute vihet re një ulje e aplikimit të dënimit me burgim, si dhe ulje e numrit të rasteve kur prokurori ka kërkuar dënimin me gjobë apo aplikimin e dënimit me kusht. Në vlerë relative, raporti i vendimeve të dënimit me burg në lidhje me numrin e përgjithshëm të pandehurve që janë gjykuar për vitin 2017 është **34.5%** (kërkesa e prokurorit **43.4%**), për vitin 2016 është **47%** (kërkesa e prokurorit **63%**).

Raporti i vendimeve të dënimit më gjobë në lidhje me numrin e përgjithshëm të pandehurve që janë gjykuar për vitin 2017 është **9.7%** (kërkesa e prokurorit **8.3%**), ndërkohë që për vitin 2016 është **15%** (kërkesa e prokurorit **13.9%**).

Ndërsa, raporti i vendimeve të dënimit më kusht në lidhje me numrin e përgjithshëm të pandehurve që janë gjykuar për vitin 2017 është **37.5%** (kërkesa e prokurorit **36.5%**), ndërkohë për vitin 2016 është **39%** (kërkesa e prokurorit **34%**).

Edhe këtë vit, nga ana e prokurorit është treguar kujdes në lidhje me kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të dënimit, ndonëse në një numër rastesh kjo kërkesë ka qënë e detyruar nisur nga rrethanat e faktit dhe rrezikshmëria e autorit të veprës penale.

Në vitin 2017, numri i rasteve kur Gjykata ka vendosur deklarin e pafajshëm të të pandehurit është **86**, ndërkohë që për vitin 2016 ky numër ka qënë **116**. Nga **86** raste kur është dhënë pafajësi, është bërë apel nga ana e prokurorit të seancës në 82 raste. Nga të dhënat vihet re që në vitin 2017 në vlerë relative pafajësitë janë **2.5%** të numrit të përgjithshëm të të pandehurve të dënuar, ndërsa në vitin 2016 kanë qënë **3.1%** të numrit të përgjithshëm të të pandehurve.

Në vlerësimin tonë, pjesa më e madhe e pafajësive të dhëna nga ana e gjykatës nuk kanë qënë të bazuara në prova dhe në ligj dhe këtë e provon dhe fakti i ankimit të pjesës më të madhe të tyre nga ana e prokurorit të cështjes.

Në krahasim me vitin 2016, është **348** me pak numri i rasteve kur nga ana e prokurorit është bërë ankim ndaj vendimit të Gjykatës. Në numrin e përgjithshëm prej 291 ankime, evidentohet se: **82** prej tyre janë për shkak të deklarin e pafajshëm të të pandehurit, 125 ankime janë bërë për masë dhe lloj dënimi, 84 ankime janë bërë për shkak të aplikimit të pezullimit të dënimit.

Nuk mund të evidentohen të dhëna përfundimtare përse i takon vendimarrjes së Gjykatës së Apelit në lidhje me ankimet e bëra nga prokurori për shkak se, një pjesë e ankimeve ende nuk janë shqyrtuar në Gjykatën e Apelit apo edhe kur ka filluar shqyrtimi ende Gjykata nuk ka disponuar me vendimit. M.gj.të nga të dhënat që ekzistojnë deri tani, nga Gjykata e Apelit janë shqyrtuar 4 raste pafajësish dhe në 2 raste Gjykata e Apelit ka pranuar ankimin e prokurorit.

III.4 HETIMI DHE GJYKIMI I TË MITURVE

Në lidhje me të pandehurit e mitur, nga të dhënat statistikore të vitit 2017 rezultojnë 96 të pandehur/nën hetim të mitur të hetuar.

Të miturit dërguar gjyqit në vitin 2017 janë 80 ku 78 janë meshkuj dhe 2 janë femra.

Kriminaliteti i të miturit sipas veprave penale paraqitet si vijon:

Vjedhja e pasurisë përbën grupveprat penale të kryera më së shumti nga të miturit 14 deri 18 vjeç, e konkretisht nga 45 të pandehur të mitur.


Një vepër tjetër penale problematike, për të cilën janë regjistruar 16 të pandehur të mitur është ajo e “Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”.

Lidhur me veprat penale kundër personit, rezulton se 5 të mitur kanë kryer vepra penale drejtuar personit.

Për veprat penale lidhur me narkotikët janë regjistruar 11 të pandehur të mitur.


Për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” janë regjistruar 3 të pandehur të mitur.

Pjesa tjetër e të miturve të regjistruar e hetuar kanë kryer vepra penale të tjera të cilat të veçuara nuk kanë peshë specifike të veçantë brenda totalit.



Masat e sigurimit me të cilat janë hetuar dhe gjykuar të miturit janë 9 të mitur me masën e sigurimit “arrest në burg”, 9 të mitur me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, 28 të mitur me masën e sigurimit “detyrim për paraqitje”, pjesa tjetër në gjendje të lirë.

Lidhur me caktimin e dënimit për të pandehurit e mitur 14 deri 18 vjeç gjatë vitit 2017, rezulton se është kërkuar për 6 të pandehur të mitur aplikimi i nenit 63 të K.Penal-vendosur nga gjykata për 8 të pandehur, aplikimi i nenit 59 për 53 të pandehur të mitur-vendosur nga gjykata për 52 të pandehur, pushimi i gjykimit në një rast-gjykata ka vendosur në dy raste, përjashtyrim nga dënimi për 9 të pandehur të mitur-gjykata ka vendosur për 11 të pandehur të mitur dhe dënimi me burgim për 26 të mitur-gjykata ka vendosur për 20 të mitur. Gjithashtu është dhënë dhe një pafajësi. Nga ana e prokurorit janë ankimuar 3 vendime të gjykatës në lidhje me ceshtjet e gjykuara me të pandehur të mitur.



IV.1. URDHËRAT E EKZEKUTIMEVE TË VENDIMEVE PENALE

Aspekt i pashmangshëm dhe ligjor i ushtrimit të funksioneve të prokurorit është edhe Ekzekutimi i Vendimeve Penale.

Për të gjitha vendimet gjyqësore të formës së prerë organi i prokurorisë ka urdhëruar ekzekutimin e tyre. Për periudhën objekt analize, janë nxjerrë 3580 (4241 për vitin 2016) urdhëra ekzekutimi për vendimet penale të dhëna nga Gjykata pranë Shkallës së Parë Tiranë. Nga 3580 urdhëra ekzekutimi, 718 (704 në vitin 2016) prej tyre janë për dënime me burgim, 341 (468 në vitin 2016) për dënime me gjobë, 1756 (1409 në vitin 2016) për dënime me kusht, dënime me ore pune dhe dënime plotësuese, 498 (896 në vitin 2016) për kthim, asgjësim dhe kalim prove materiale në favor të shtetit dhe 267 (768 në vitin 2016) urdhëra për shpenzime proceduriale.

Janë ekzekutuar gjithsej 895 (643 për vitin 2016) urdhëra ekzekutimi të vendimeve penale, prej të cilave 510 (435 për vitin 2016) për dënime me burgim, 55 (27 për vitin 2016) për dënime me gjobë, 173 (97 për vitin 2016) dënime me ore pune dhe permbushje e detyrimit për dënime me kusht, për dënime plotësuese, 67 (53 për vitin 2016) për shpenzime proceduriale dhe 90 (29 për vitin 2016) për kthim e asgjësim prove material dhe kalim prove në favor të shtetit.

Janë në fazën e ekzekutimit 2685 (3598 në vitin 2016) urdhëra, prej të cilave 208 (269 në vitin 2016) për dënime me burgim, 286 (435 për vitin 2016) për dënime me gjobë, 200 (715 në vitin 2016) për shpenzime proceduriale dhe 408 (867 në vitin 2016) për kthim e asgjësim prove materiale, si dhe

1583 (1312 në vitin 2016) vendime me kusht dhe denime me ore pune jane ne mbikqyrje nga Sherbimi i proves.

Në formë statistikore të dhënat lidhur me urdhërat e ekzekutimit të nxjerra nga prokurori për ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

URDHËRA PËR EKZEKUTIM						
Burg.përjet.	Burgim	Gjobë	Dënime Me kusht, ore pune dhe denime plotësuese	Shpenzime proceduriale	Kthim asgjësim dhe kalim ne fv. te shtetit te proves materiale.	Shuma
0	718	341	1756	267	498	3580
URDHËRA TË EKZEKUTUARA						
Burg.përjet.	Burgim	Gjobë	Dënime me kusht ore pune dhe plotësuese	Shpenzime proceduriale	Kthim asgjësim prove kalim ne favor shtetit	Shuma
0	510	55	173	67	90	895
URDHËRA NË EKZEKUTIM						
Burg.përjetshem.	Burgim	Gjobë	Dënime me kusht ore pune dhe plotësuese	Shpenzime proceduriale	Kthim asgjësim dhe kalim ne fv.te shtetit.	Shuma
0	208	286	1583	200	408	2685

Në zbatim te pikes 5, te nenit 48 te ligjit nr.10193, date 03.12.2009 dhe te udhezimit te perbashket te Prokurorit te Pergjithshem dhe Ministrit te Brendeshem “Per shpallje ne kerkim nderkombetar” te dates 29.06.2010, per personat e denuar me vendim te formes se prerë, nje vemendje e vecate i eshte kushtuar dhe shpalljes ne kerkim nderkombetar te personave te denuar me vendim te formes se prerë. Keshtu per vitin 2017 jane nxjerre urdherat per shpallje ne kerkim nderkombetar per 96 persona te denuar ne mungese me vendim te formes se prerë.

Mbikëqyrja e zbatimit të ekzekutimeve të vendimeve penale ka qene ne nivele te kenaqeshme krahasuar kjo me vitet e kaluara. Për këtë kanë ndikuar edhe takimet periodike që janë bërë me strukturat pranë Drejtorisë Rajonale Vendore dhe të Komisariateve në veçanti, që merren me ekzekutimet e vendimeve penale, me Drejtoritë e Burgjeve, Zyrën e Përmbarrimit Tiranë, Zyren vendore te Sherbimit te Proves Tirane. Duhet thënë që është rritur përgjegjësia në ekzekutimin në kohë të vendimeve penale. Me Drejtorinë Rajonale Vendore Tiranë janë përfunduar, evidentimi i plotë i personave që janë me vendime penale të paekzekutuara si dhe plotësimi i dokumentacionit dhe te dhenave për personat e denuar me vendim te formes se prere te cilet jane në kërkim me qellim shpallje ne kerkim nderkombetar te ketyre personave. E njëjta gjë po bëhet edhe me Zyrën e Përmbarrimit Tiranë problem mbetet ekzekutimi i vendimeve per personat e denuar me gjobe dhe qe nuk kane mundesi shlyerje dhe pasuri te regjistruara ne zyrat perkatese te regjistrimit te pasurive. Persa i perket personave te denuar me kusht dhe me ore pune urdherat e ekzekutimit i janë derguar sherbimit te proves. Bashkepunimi me keto zyra ka qene i mire dhe ne rastet kur nuk permbushen detyrimet nga personat e denuar eshte bere revokimi i denimeve alternative. Per vitin 2017 jane bere 54 kerkesa per revokim te denimeve alternative. Si rezultat i kesaj personat e denuar kane filluar te ndjejne pergjegjesine e denimit me kusht, gje e cila ka efektet e veta parandaluese ne luften ndaj kriminalitetit. Ketu mbetet problem mospasqyrimi i sakte i adresave nga oficeret e policise gjygesore ne momentin e pyetjes se personave te dyshuar, pasi kjo sjelle me pas veshtiresi ne gjetjen e personave dhe mbikqyrjen e denimeve alternative nga ana e sherbimit te proves.

- **Shpenzimet proceduriale.**

Gjatë këtij viti i është kushtur kujdes i vecantë edhe përlllogaritjes së shpenzimeve proceduriale, ku cdo prokuror për dosje të përfunduar ka perlllogaritur shpenzimet proceduriale me formular të vecantë. Për çështjet që janë gjykuar në çdo rast është kërkuar nga gjykata që në vendimin përfundimtar të disponojë edhe për shpenzimet proceduriale. Për çështjet të cilat janë pushuar për shkak të heqjes dorë nga ankuesi, shpenzimet proceduriale janë arkëtuar.

Në këtë aspekt, hasen mjaft vështirësi përse i takon arkëtimit. Kjo sepse shpesh qytetarët refuzojnë arkëtimet me argumentin se janë në pamundësi ekonomike.

IV.2. CESHTJET E PERFAQESUARA NE GJYKATE

Per periudhen Janar – Dhjetor 2017 eshte marre pjese ne perfaqesimin e 490 (775 në vitin 2016) kerkesave me objekte te ndryshme gjykimi. Tabela në vijim, pasqyron në mënyrë të detajuar treguesit si përsa i takon prokurorëve, ashtu edhe objektit të gjykimit.

Nr	OBJEKTI I GJYKIMIT	Shuma	PROKURORËT				
			P. Bica	A. Prifti	A. Cama	Sh. Pasha	A. Moçka Hamiti
1	Lirim para kohe me kusht	9	3	1	0	5	0
2	Qëndrim në shtëpi	5	3	2	0	0	0
3	Komp. burgim të padrejtë	28	28	0	0	0	0
4	Revokim vendimi per denimet alternative	48	9	9	0	30	0
5	Ndryshim i inst.vuajtjes dënimit	4	1	0	0	3	0
6	Bashkim dënimesh	39	7	6	2	24	0
7	Shtyrje ekz. dënimi	6	1	2	0	3	0
8	Pezullim i ekzekutimit të dënimit	34	4	11	0	19	0
9	Heqje zotësisë për të vepruar	5	0	3	0	2	0
10	Rrahje	6	1	1	0	4	0
11	Fyerje	16	1	11	0	4	0
12	Shpifje	15	0	11	0	4	0
13	mos ekz dënimi	0	0	0	0	0	0

14	Mosdhënie mjete për jetesë	9	1	5	0	3	0
15	Zbatim ligji për amnistinë	48	8	9	0	31	0
16	Njohje e vendimit penal të huaj	13	0	0	0	0	13
17	Njohja e ditëve të punës	0	0	0	0	0	0
18	Plotësim të vendimit penal	1	0	1	0	0	0
19	Revokim e mase mjekësore	14	6	0	0	8	0
20	Njohje e kohës paraburgimit	14	6	0	0	8	0
21	Rip.pa te drj.te vepres tjetrit	0	0	0	0	0	0
22	Rehabilitim	11	1	0	0	10	0
23	Shuarje mase sigurimi	0	0	0	0	0	0
24	Ekstradime	44	3	0	0	2	39
25	Ekzekutim letërporosi	140	0	0	0	2	138
26	Objekte te ndryshme	15	6	0	0	9	0

Sic duket edhe nga përmbledhja e shifrave viti 2017 ka patur fluks të kërkesave lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, si në aspektin e kryerjes së veprimeve hetimore me letërporosi ashtu edhe në aspektin e kërkesave për ekstradim dhe njohje vendimesh. Në të gjitha rastet nga Prokuroria janë bërë kërkesat në kohë dhe vlen për tu theksuar që, nuk ka patur asnjë rast ku nga gjykata të mos jetë pranuar kërkesa për ekstradim ose njohje e vendimit penal të huaj.

IV.3 LIRIMET ME KUSHT

Nga ana e prokurorëve të seksionit, është marrë pjesë në gjykimin dhe janë perfunduar 9 kërkesa me objekt “lirim me kusht”. Të gjitha kërkesat janë pranuar nga ana e gjykatës.

Gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave janë vlerësuar me objektivitet kriteret, duke mos pranuar kërkesat për lirim me kusht për të dënuar të cilët kanë kryer vepra të rënda penale. Vështirësi janë hasur dhe vazhdojnë të hasen në vlerësimin e kriterit “*arsye e veçantë për lirim me kusht*”, (neni 64 i Kodit Penal), për faktin se ende nuk ka një konsolidim të praktikës gjyqësore për këtë kriter.

V. PROBLEMATIKAT GJATË HETIMIT DHE GJYKIMIT

Gjatë vitit 2017 është bashkëpunuar me shërbimet e policisë gjyqësore të institucioneve të ndryshme si ato të policisë së shtetit, Drejtorisë së Hetimit Tatimor, atij doganor, etj.

Këto struktura të policisë gjyqësore kanë bërë përpjekje për realizimin me sukses të veprimtarisë së tyre hetimore. Strukturat e policisë në shumicën e rasteve kanë njoftuar prokurorin për ngjarjet e ndodhura, duke mundësuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen e tij në vendngjarje, apo edhe konsultimin për veprimet që do të kryhen.

Megjithatë gjatë punës janë vërejtur dhe problematikat si më poshtë vijon;

- Lëvizja e oficerëve të policisë gjyqësore nga një qark në tjetrin dhe nga një strukturë në tjetrën brenda drejtorisë. Problematika e mësipërme përbën një ndër shkaqet kryesore të vonesave në kryerjen e veprimeve hetimore të shpejta si edhe me cilësinë e hetimit.
- Nevoja e një trajnimit për oficerët e policisë gjyqësore lidhur me respektimin nga ana e tyre të normave procedurale në veprimet hetimore që kryhen kryesisht në momentin e parë të ndodhjes së ngjarjes. Nga analiza jonë rezulton se në shumë dosje ka mangësi sa i përket respektimit të normave procedurale që kryhen me personat nën hetim, personat e mitur të pyetur si deklarues, për këqyrjen e vendit të ngjarjes, sekuestrot, kontrollet dhe në përgjithësi me konceptin e mjeteve të kërkimit të provës dhe provës në vetvete.
- Nevoja për konsultim me prokurorin në rastet e ndalimeve konform nenit 253 të K.Pr.Penale dhe rastet e arrestimeve në flagrancë ku dukshëm nga oficeri i policisë gjyqësore abuzohet me këtë kompetencë që ligji ia ka dhënë policisë. Nga konsultimi që bëhet me oficerët e policisë gjyqësore rezulton se shpeshherë arrestimet në flagrancë, por edhe ndalimet kryhen me urdhër të drejtuesve të policisë, duke hequr kështu mundësinë e vlerësimit ligjor të çdo rasti nga oficeri i policisë gjyqësore. Praktika të tilla janë vlerësuar në disa raste si të paligjshme nga ana e prokurorëve dhe janë vendosur lirime të menjëhershme.

- Gjatë vitit 2017, si edhe në vitet paraardhëse, janë konstatuar një sërë rastesh ku janë arrestuar në flagrancë persona të ndryshëm me sasira shumë të vogla lëndë narkotike cannabis sativa me gjithë diskutimet e vazhdueshme të kryera me drejtuesit e komisariateve, problematika vazhdon dhe të gjitha këto çështje përfundojnë me pushimin e hetimeve për mungesë të elementëve të veprës penale.
- Numri i madh i dosjeve të referuara nga policia gjyqësore të cilat përfundojnë me vendimin e mosfillimit të prokurorit, me shkakun se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ndërkohë që nga ana e oficerit që referon çështjen kanë qenë të gjitha mundësitë për vlerësimin më të drejtë të çështjes.
- Cilësia e referimeve të veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Në dosjen që referohet në Prokurori nuk ka asnjë akt provues, përjashtuar informacionit për referimin e veprës penale dhe nga ana e oficerëve nuk kryhet asnjë verifikim tjetër i nevojshëm për regjistrimin e veprës penale nga ana jonë. E njëjta problematikë konstatohet edhe në rastet e informacioneve të Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave, të cilat informojnë vetëm transaksione të dyshimta pa asnjë dyshim për aktivitet kriminal të mundshëm.
- Mendojmë se numri i oficerëve të policisë gjyqësore të Drejtorisë Hetimore të Tatimeve, Tiranë duhet të jetë më i madh, nisur nga fakti se procedimet e referuara dhe hetuara nga ky seksion janë jo të pakta në numër, voluminoze dhe me shumë veprime hetimore dhe ky seksion mbulon jo vetëm Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, por edhe prokurori të tjera gjë që bën të vështirë hetimin në rrethe të ndryshme dhe zgjat afatet e hetimit të procedimeve penale. Gjithashtu mendojmë që në përbërjen e tyre duhet të ketë dhe specialistë me njohuri të posacme në fushën ekonomiko-financiare.
- I njëjti arsyetim i mësipërm vlen dhe për sektorin e krimit ekonomiko-financiar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Mendojmë se policia gjyqësore nuk duhet të merret me punë të tjera operative, sepse angazhimi i tyre me problematika të tjera zvarrit hetimin (mungesë në numrin e agentëve). Cilësia e materialeve të referuara lë për të dëshiruar. Seksioni kundër krimit ekonomiko-financiar nuk ka njohuritë e duhura të ligjeve organike në fushën tatimore, doganore gjë që con në mosfillime të shumta. Pavarësisht se është diskutuar shumë herë në lidhje me këtë problem, vazhdon po e njëjta problematikë. Dhe nga ana e seksionit kundër korrupsionit materialet e para hetimore janë të vagëta, gjë që krijon problematikë në kryerjen e veprimeve proaktive. Duhet të jenë më aktivë në mbledhjen e informacioneve, dokumentimin e tyre sipas ligjit dhe bërjen e referimeve cilësore. Dhe për këtë seksion vlejnë të gjitha problematikat që janë përmendur më sipër për policinë e shtetit.

- Në lidhje me Drejtorinë Hetimore të Doganave, çështjet e referuara nga ana e tyre janë shumë të pakta, por nga ana e tyre ka angazhim për të kryer veprimet hetimore të deleguara.
- Hetimi është jokrijues, jodinamik dhe relacionet e OPGJ-ve janë thjesht paraqitje e veprimeve të kryera sipas listimit të veprimeve në urdhrin e prokurorit dhe jo analizë e provave të evidentuara, duke sugjeruar zgjidhje të çështjes të pambështetura në rezultatet e hetimeve, ose relacioni i përcillet prokurorit për vlerësim, pa sugjeruar asnjë zgjidhje përfundimare.
- Edhe nga oficerët e policisë gjyqësore pranë prokurorisë konstatohet se zvarriten hetimet, ato kryhen jo në dinamikë, mbajnë qëndrim pasiv ndaj hetimit duke përdorur mënyrën shkresore të marrjes së provave.
- Të gjithë oficerët e policisë gjyqësore duhet të jenë të kujdesshëm në marrjen e adresave sa më të sakta si të personave që pyeten si deklarues po ashtu dhe të atyre që pyeten nën hetim, pasi pasaktësia e adresave shkakton problematikë gjatë fazës së hetimit, gjykimit por vecanërisht ekzekutimit të vendimeve penale.
- Problematikë është dhe fakti i kryerjes me vonesë të akteve të ekspertimit kimik, toksikologjik, kompjuterik nga ana e Institutit të Policisë shkencore, problematikë e cila ka disa vite që ekziston. Vonesat në kryerjen e ekspertimeve kanë sjellë zvarritje dhe zgjatje të hetimeve dhe afateve të paraburgimit për një sërë procedimesh penale me persona me masë sigurie “arrest në burg”. Dhe kjo problematikë është ngritur shumë herë dhe është diskutuar gjerësisht, por vazhdon të jetë në të njëjtat parametra.

Një problem serioz vazhdon të jetë si edhe në vitet e mëparshme kryerja dhe administrimi në kohë i akteve të ekspertimit mjekoligjor dhe tekniko-shkencor. Në vlerësimin tonë, puna e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Drejtorisë së Policisë Shkencore në këtë drejtim, nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe ka sjellë pasoja në shpejtësinë e verifikimit të një pjesë të konsiderueshme të materialeve kallëzuese. Ky shqetësim është paraqitur në vazhdimësi strukturave drejtuese të kësaj Drejtorie, por akoma nuk ka marrë zgjidhjen e duhur.

Persa i përket fazës së gjykimit vlen të theksohet se pjesëmarrja e prokurorëve ka qenë korrekte dhe mungesat në seanca kanë qenë për arsye objektive (seminare, gatishmëri etj).

Në disa raste vendimet gjyqësore të pafajësisë apo pushimit të çështjes, në këndvështrimin tonë, vecanërisht kur të pandehur janë funksionar drejtues të institucioneve shtetërore janë rrjedhojë e një analize jo të plotë të provave, fakteve dhe elementëve të veprës penale, domethënë të pabazuara në ligjin penal material e atë procedural. Nga ana jonë është ushtruar e drejta e ankimimit të tyre në Gjykatën e Apelit.

VI. ZËVENDËSIMI I PROKURORËVE

Gjatë periudhës objekt analize, konstatohet se në një numër prej 392 (688 në vitin 2016) rastesh procedimesh penale është proceduar me vendim të drejtuesit për zëvendësimin e prokurorit. Shkaqet tipike për të cilat është vendosur ky zëvendësim janë:

Së pari, Kalimi i procedimeve penale për ndjekje të mëtejshme në nga një seksion në tjetrin ose në seksionin e të miturve, ku ndjekja e mëtejshme e procedimit penal është bërë nga prokurorët e këtyre seksioneve.

Së dyti, Komandimi i prokurorëve në Prokurori të tjera, mungesa e disa prokurorëve për arsye shëndetësore.

Së treti, Rastet e tjera të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

Janë hasur edhe pak raste të zëvendësimeve të panevojshme të cilat kryesisht kanë ardhur nga ankesat e palëve në proces, që kanë detyruar prokurorin që të japë pëlqimin për zëvendësimin e tij për të shmangur krijimin e mosbesimit. Ndonëse raste të tilla janë në numër të vogël, përsëri mbeten të pajustificuara dhe nuk duhet të përsëriten.

VII. VEPRIMTARIA E DREJTUESIT DHE ZV/DREJTUESIT DHE DREJTUESVE TË SEKSIONEVE

Veprimtaria e Drejtuesve të seksioneve ka synuar në menaxhimin e shërbimeve të policisë gjyqësore të seksioneve përkatëse, bashkërendimit të punës së tyre me atë të prokurorëve, mbajtjes së kontakteve të përditshme me shefat e seksioneve me qëllim për evidentuar problematikën dhe zgjidhjen e saj. E gjithë problematika në tërësinë e saj, i është bërë e ditur në çdo rast Drejtuesit të Prokurorisë, i cili nga ana e tij jo vetëm që në çdo moment ka patur një informacion të plotë mbi gjendjen, por edhe ka marrë masat që problematika të bëhej prezente edhe në nivele më të larta të Prokurorisë së Përgjithshme dhe Policisë së Shtetit.

Veprimtaria e Drejtuesit dhe Drejtuesve të Seksioneve ka konsistuar edhe në kontrollin e përditshëm të disiplinës në punë të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit të administratës, si dhe etikës së tyre.

Nga ana e stafit drejtues i është kushtuar një vëmendje e veçantë trajtimit të ankesave dhe kërkesave të paraqitura nga qytetarë të ndryshëm, apo edhe subjekte të tjera. Në çdo rast, me shpejtësi është bërë verifikimi i duhur, është kontrolluar ecuria e hetimeve, është komunikuar me prokurorin përkatës dhe në përfundim është sqaruar kërkuesi apo ankuesi.

VIII. RAPORTET ME INSTITUCIONET E TJERA

Gjate ketij viti jane mbajtur raporte korrekte me institucione te tjera, ne zbatim te ligjit procedural dhe atij organik per Prokurorine. Ne keto marredhenie rolin kryesor e zene ato qe lidhen me :

- Prokurorine e Pergjithshme,
- Strukturat e policise se shtetit dhe institucionet e tjera qe perfshijne sherbime te policise gjyqesore, per bashkepunimin qe lidhet me fazen e hetimit paraprak te procedimeve,
- Me Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tiranë, per fazen qe lidhet me perfaqesimin e akuzes ne gjykim,
- Me Prokurorine e Apelit Tiranë, per fazen qe lidhet me perfaqesimin e akuzes ne ceshtjet e ankimuar,
- Me institucione te tjera ne nivel lokal.

VIII.1 RAPORTET ME PROKURORINË E PËRGJITHSHME

Gjate gjithë vitit 2017 ka patur bashkepunim me te gjitha drejtorite dhe sektoret e Prokurorise se Pergjithshme.

Ka patur gatishmeri per bashkepunim dhe ndihme të Prokurorise pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nga Drejtoritë përkatëse në funksion të hetimit të procedimeve penale, vecanerisht ato me veprime proaktive. Nga seksioni i ekzekutimit pranë kësaj prokurorie është bashkëpunuar me Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë në lidhje me kërkesat për ekstradime apo dhe njohje vendimesh penale të huaja etj.

VIII.2 RAPORTET ME STRUKTURAT E POLICISË SË SHTETIT

Gjate vitit 2017, pervec respektimit te detyrimeve ligjore dhe ne funksion te rritjes se cilesise se hetimit paraprak, eshte synuar forcimi i raportit te bashkepunimit me te gjitha strukturat e policise se shtetit qe veprojne ne qytetin e Tiranës, si Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria Rajonale Vendore, Komisariatet e ndryshme etj.

Gjate vitit 2017, nga pikepamja formale, jane respektuar detyrimet e Urdherit te Perbashket, kur per procedimet penale qe jane regjistruar mbi bazen e materialit te referuar nga sherbimet e policise gjyqesore, hetimi prej prokuroreve eshte deleguar tek oficeret e policise gjyqesore te sherbimeve perkatese.

Si pasoje e nje raporti te tille, ne rastet kur jane evidentuar te meta ne ceshtjet ne hetim, ato jane trajtuar ne kohe dhe orientuar drejt zgjidhjes se tyre, me qëllim që të mos përsëriten më në të ardhmen.

Prokuroret kane qene prezent ne vendngjarjet e renda kriminale, si ato te veprave kunder jetes se personit, aksidenteve te renda automobilistike etj.

Ne drejtim te rritjes se cilesise se hetimit paraprak eshte edhe vijimi i takimeve te perbashketa periodike ndermjet drejtuesve te kesaj Prokurorie dhe drejtuesve te efektivave policore qe disponojne sherbimet e policise gjyqesore, praktike e cila tashme eshte e konsoliduar.

Gjate ketij viti, nen kujdesin e drejtuesve te kesaj zyre, kane vijuar raportet e bashkepunimit edhe me strukturat qendrore dhe vendore te tatim-taksave, doganave, etj, ne funksion te hetimit profesional te veprave penale ne ato fusha.

VIII.3 RAPORTET ME GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR

Kujdes i vecante eshte treguar dhe do te tregohet edhe në të ardhmen në marrëdhëniet e prokurorëve me Gjykatën.

Në këtë drejtim, në punën tonë kemi synuar të respektojmë në cdo rast pavarësinë dhe paanësinë e gjykates, në veçanti duke mos hedhur dyshime mbi vendimet gjyqësore dhe as të vonojmë ekzekutimin e tyre, përvec rastit kur ushtrohet e drejta e apelit.

Kemi synuar dhe synojmë që prokurorët të jenë profesionalë, objektivë dhe të ndershëm gjatë procedurave gjyqësore, veçanërisht duke siguruar që gjykatës t'i jenë paraqitur të gjitha faktet që kanë lidhje me akuzën e ngritur dhe argumentat ligjore të nevojshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.

Në të gjithë këtë raport me sistemin gjyqësor mbajmë në konsideratë faktin se Prokuroria ka për detyrë të ngrejë akuzë në emër të shtetit dhe përgjigjet për efektivitetin e luftës kundër kriminalitetit, ndërsa gjykata duhet të japë drejtësi pas zhvillimit të një procesi gjyqësor të drejtë.

Raportet e kesaj zyre me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kane qene korrekte dhe ligjore, ne perfaqesimin e akuzes ne kerkesat qe lidhen me fazen e hetimit paraprak dhe ate te gjykimit të kërkesave të prokurorëve qoftë për pushim, qoftë për dërgimin për gjykim e gjykimin në themel.

Nderkohe qe ka patur nje bashkepunim dhe mirekuptim te plote me kryetarin e Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tiranë, ne rastet e masave të sigurimit duke caktuar dy gjyqtarë të gatshëm dhe bërë të mundur gjykimin e këtyre kërkesave në kohën e duhur.

VIII.4 RAPORTET ME PROKURORINË E APELIT

Gjate vitit 2017 ka patur nje komunikim te vazhdueshem me Prokurorine e Apelit Tiranë, ne funksion te perfaqesimit sa me cilesor te akuzes ne ceshtjet e ankimuara. Ky bashkepunim, ne respektim te percaktimeve procedurale dhe udhezimit perkates te Prokurorit te Pergjithshem, eshte shtrire si per ceshtjet ku akuza eshte perfaqesuar me autorizim nga prokurore te kesaj zyre, ashtu edhe diskutimin e ceshtjeve te perfaqesuara nga prokuroret e apelit.

Edhe gjate vitit 2017 ka vijuar praktika shume e mire qe apelimet e prokurore te shkalles se pare, si per masat e sigurimit dhe per vendimet perfundimtare, krahas depozitimit ne gjykate dergohen paralelisht per njoftim edhe ne Prokurorine e Apelit, po ashtu edhe njoftimi qe Prokuroria e Apelit i dergon kesaj zyre per vendimet perfundimtare ne shkallen e dyte te gjykimit, per cdo tremujor.

IX. PRIORITETE TË PUNËS PËR PERIUdhËN E VITIT 2017

1. **Lufta kundër korrupsionit** ka qenë dhe mbetet një ndër prioritetet e punës së prokurorisë. Në funksion të këtij prioriteti, me synim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe për të përmirësuar cilësinë dhe efektivitetin në hetimin dhe ndjekjen penale kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit, do të vazhdojnë të rritet bashkëpunimi me institucionet ligjzbatuese si Drejtorinë e Hetimit Tatimor, SHCBA, SHISH, Drejtorinë e Hetimit Doganor si dhe shërbimet inteligjente.

2. **Lufta kundër trafikeve të paligjshme dhe pastrimit të parave** do të vazhdojë të jetë prioritet i punës sonë. Për realizimin e këtij prioriteti do të fokusohemi kryesisht:

- Në forcimin e bashkëpunimit me agjensitë e zbatimit të ligjit brënda vendit, duke i dhënë rrugë kryesisht hetimeve proaktive për goditjen e këtij lloj kriminaliteti.
- Shfrytëzimin në maksimum të të gjithë materialit informativ që vjen nga agjensitë e ndryshme të shërbimeve inteligjente.

3. **Lufta kundër veprave penale të vjedhjes së pasurisë**, me tendencë në rritje në vitin e kaluar do të jetë prioritet i prokurorisë për sa kohë ajo konsiderohet e lidhur ngushtë me sigurinë publike, në drejtim të rritjes së efektivitetit në zbulueshmërinë e këtyre krimeve por edhe në ashpërsimin e politikës penale ndaj tyre.

4. **Lufta kundër krimeve ndaj jetes dhe shendetit**, krimeve brenda familjes, krimet ne fushen e qarkullimit rrugor, etj

Nga tendencat e vëna në dukje në këtë raport, është e qartë se punë mjaft e mirë është bërë deri tani, por probleme ende ka dhe do të jenë në fokusin e punës tonë duke besuar dhe shpresuar ne realizimin e

prioriteteve në luftë kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimit të organizuar, korrupsionit në veçanti duke rritur efektivitetin në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit si dhe duke garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Pavarësisht volumit të jashtëzakonshëm të punës që është përballuar për vitin 2017 që u përshkrua me detaje më lart, për vitin 2018, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë mbetet si prioritet kryesor përmirësimi i treguesve sasiorë dhe cilësorë të ndjekjes penale dhe të gjykimit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet hetimit dhe ndjekjes penale për të gjithë veprat penale që janë bërë fenomen shqetësues për shoqërinë dhe ato që janë prioritet i ekzekutivit shqiptar.

Për këtë qëllim do të synohet që të rritet më tej roli i prokurorit në kontrollin e veprimtarisë së policisë gjyqësore. Kjo do të konsistojë në hetimin e gjitha versioneve të mundshme hetimore, duke evidentuar, fiksuar dhe marrë të gjitha provat që i takojnë ekzistencës së faktit kriminal dhe atyre të fajësisë. Përpilimin nga ana e policisë gjyqësore, në formën e duhur procedurale të gjitha akteve të hetimit paraprak, me qëllim shmangien e probleme të mundshme në momentin e gjykimit, në lidhje me vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e tyre. Në çdo rast që do të evidentohen probleme të karakterit procedural, ato do të bëhen pjesë e një analize të hollësishme dhe të përgjegjshme me të gjithë stafin e policisë gjyqësore të sektorit përkatës.

Do të synohet për rritjen e shpejtësisë në hetim dhe kjo do të arrihet nëpërmjet një kontrolli të afateve të përcaktuara nga prokurori për kryerjen e veprimeve hetimore, marrjes së masave disiplinore në ato raste kur konstatohen zvarritje, rritjes së numrit të rasteve të gjykimit të drejtëpërdrejtë.

Vëmendje e veçantë do vazhdojë t'i kushtohet respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personit, veçanërisht të miturve autorë të veprave penale, ç'ka do të arrihet nëpërmjet vlerësimit më me kujdes të momentit të "arrestit në flagrancë" dhe "ndalimit".

Të miturit si subjekt aktiv po ashtu dhe si viktima të veprave penale janë trajtuar në mbështetje të dispozitave të K.Pr.Penale, ku në çdo rast në të gjitha veprimet e kryera me to kanë qenë të pranishëm si prindi, avokati mbrojtës, psikologu etj. Dhe për këtë vit këta subjekte do vazhdojë të jetë prioritet për punën tonë për më tepër që në janar të vitit 2018 ka hyrë në fuqi dhe Kodi i Drejtësisë për të Miturit.

Prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale në hetim dhe gjykim, duhet të tregojnë kujdesin maksimal në drejtim të përpilimit dhe arsyetimit të akteve përfundimtare të cilat duhet të jenë të argumentuara edhe me arsyetimin e nevojshëm mbi bazën e provave të administruara dhe kërkesat e ligjit dhe të forcojnë kontrollin për sa i takon strukturave të shërbimeve të policisë gjyqësore.

Do të synohet ulja e ngarkesës për secilin prokuror duke e afruar me atë mesatare të të gjithë Republikës, mbasi kjo do të sillte përmirësime në cilësinë dhe shpejtësinë e hetimit dhe do të rriste efikasitetin e ndjekjes penale. Për këtë qëllim, nëpërmjet ndërgjegjësimit të strukturave të policisë gjyqësore, do të evitohet referimi i panevojshëm në Prokurori i veprave penale që nuk janë në

kompetencë të saj, ose në rastet kur mungon ankimi nga i dëmtuari. Po ashtu, do të konsiderohet një shpërndarje më e drejtë e prokurorëve në seksionet e kësaj Prokurorie.

Prokurorët duhet të tregojnë vëmendje dhe akoma më tepër përkushtim në hetimin e veprave penale të kryera në detyrë, të cilat janë sensitive në sytë e publikut, ku dhe goditja e tyre ka efikasitetin më të madh në parandalimin e kriminalitetit.

Gjithashtu duhet të vazhdojmë rritjen e perpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e treguesve të zbulueshmerisë së veprave penale me rrezikshmeri të lartë shoqërore, si vrasjet, vjedhjet etj, të cilat janë me të ndjeshme për komunitetin. Perfundimi me sukses për akuzën për fazën e gjyqimit të ceshtjeve që lidhen me ngjarje të rënda kriminale të viteve të mëparshme, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimet policore, për t'u dhënë mesazhin autorëve të këtyre krimeve se nuk mund të shpëtojnë ndeshkimit ligjor pavarësisht kohës që ka kaluar.

Duhet të rritet funksioni drejtues dhe kontrollues i prokurorit ndaj policisë gjyqësore, në seksionin dhe shërbimet e policisë gjyqësore.

Gjithashtu do të vazhdojmë të tregojmë kujdesin e duhur në ruajtjen e figurës së pastër për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, respektimin prej tyre të normave të etikës dhe të sjelljes së denjë në publik.

Në mënyrë të përmbledhur, këto ishin rezultatet e arritura dhe problemet e hasura gjatë veprimtarisë tonë një vjeçare. Jemi të ndërgjegjshëm se, ndonëse janë konstatuar tregues sasiore dhe cilësorë në përgjithësi pozitivë, mbetet akoma punë që ato të arrijnë në nivele më të larta. Besojmë se edhe zhvillimi i debatit në këtë analizë do t'i shërbejë këtij qëllimi.

Bashkëlidhur me raportin janë pasqyrat me treguesit analitik për secilin prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore për hetimet paraprake dhe gjykimin, pasyra e zgjatjeve të afatit, si dhe pasqyra e pafajësive.

DREJTUESI I PROKURORISË

DRITAN RRESHKA

PROCEDIMET NE HETIM PARAPRAK PROKURORET 2017

Nr.	Prokurori	Kallezime të marra 2017	Mosfillime	Menyra e Perfundimit					Gjithsej përfunduar	Në hetim total
				Total	Gjyqi	Pushuar	Pezulluar	Koperencë		
				Proçedim		çeshtje				
1	A. Nela	0	0	0	0	0	0	0	0	
2	A.Allajbeu	291	122	214	40	17	68	2	127	87
3	A.Braho	246	94	163	26	34	50	3	113	50
4	A.Bramo	144	77	57	5	7	13	1	26	31
5	A.Cama	205	77	228	50	35	69	17	171	57
6	A.Demirneli	303	198	180	40	29	84	1	154	26
7	A.Dyrmishi	332	124	265	140	41	39	3	223	42
8	A.Galanxha	267	129	164	35	17	85	4	141	23
9	A.Gurakuqi	122	37	177	11	24	57	4	96	81
10	A.Hamitaj	9	0	9	4	2	1	0	7	2
11	A.Kraja	331	109	304	82	61	84	0	227	77
12	A.Lulaj	306	85	276	35	54	81	1	171	105
13	A.Mersini	272	153	177	37	35	78	1	151	26
14	A.Ndoi	188	87	150	31	12	73	1	117	33
15	A.Permeti	305	142	215	42	25	87	1	155	60
16	A.Prifti	10	1	10	5	1	3	0	9	1
17	A.Qilimi	275	65	259	11	44	55	1	111	148
18	A.Sevdari	83	50	65	20	12	15	3	50	15
19	A.Xhelili	234	144	118	34	19	48	1	102	16
20	A.Zifla	253	107	258	126	18	34	2	180	78
21	B.Breçani	110	30	76	11	11	10	0	32	44
22	B.Cani	278	71	282	118	37	31	0	186	96
23	B.Cengu	0	0	0	0	0	0	0	0	0
24	B.Hoxha	311	173	141	31	16	61	1	109	32
25	B.Maksuti	263	144	142	46	17	57	4	124	18
26	B.Mete	281	105	265	35	34	60	3	132	133
27	D.Katro	133	62	65	0	1	64	0	65	0
28	D.Nushi	183	97	146	40	24	80	2	146	0
29	D.Rreshka	34	38	22	6	8	3	1	18	4
30	D.Sulaj	283	86	216	12	42	55	2	111	105
31	E.Bala	73	24	50	10	1	10	2	23	27
32	E.Bimi	242	107	153	34	27	37	2	100	53
33	E.Bregova	254	97	227	53	42	80	4	179	48
34	E.Celami	282	152	184	62	26	63	1	152	32
35	E.Gjini	304	123	225	56	34	66	7	163	62
36	E.Imeraj	256	125	126	23	11	42	2	78	48
37	E.Kapo	301	139	194	48	16	115	6	185	9

Nr.	Prokurori	Kallezime të marra 2017	Mosfillime	Menyra e Perfundimit					Gjithsej përfunduar	Në hetim total
				Total	Gjyqi	Pushuar	Pezulluar	Kopetenc		
38	E.Ndoci	13	0	4	0	0	0	0	0	4
39	E.Karaxha	305	164	203	61	37	67	3	168	35
40	E.Kareci	367	114	305	153	33	51	3	240	65
41	E.Kombi	252	91	210	80	27	60	5	172	38
42	E.Mazreku	312	147	248	53	42	80	3	178	70
43	E.Miha	143	66	132	20	22	40	0	82	50
44	E.Pano	1	1	1	0	0	0	0	0	1
45	G.Qana	269	162	171	48	29	62	4	143	28
46	G.Shahu	19	0	9	0	0	0	0	0	9
47	Gj.Kodra	300	132	221	60	28	103	3	194	27
48	Gj.Tako	197	17	223	78	46	24	48	196	27
49	H.Keta	7	0	0	0	0	0	0	0	0
50	H.Mulaj	25	23	46	14	9	23	0	46	0
51	I.Ahmetlli	264	166	138	30	24	43	4	101	37
52	I.Jata	274	89	213	138	14	16	2	170	43
53	J.Xhengo	277	107	257	32	71	66	3	172	85
54	J.Zonja	268	89	273	70	51	92	2	215	58
55	K.Berberi	369	120	278	130	29	32	0	191	87
56	K.Hysenaj	136	55	72	6	8	29	3	46	26
57	K.Shahu	301	112	225	34	24	125	1	184	41
58	L.Riza	2	0	2	0	0	0	0	0	2
59	L.Ziguri	289	151	183	24	14	104	2	144	39
60	M.Bushi	154	71	137	78	14	44	1	137	0
61	M.Mertiri	33	22	40	0	9	8	2	19	21
62	M.Zaimi	264	134	167	49	30	67	3	149	18
63	M.Zavalani	288	119	218	42	49	76	5	172	46
64	N.Tavani	295	111	219	35	70	47	3	155	64
65	N.Tota	263	138	176	61	26	50	2	139	37
66	O.Dado	271	152	152	47	14	79	0	140	12
67	P.Bica	12	0	14	6	0	2	0	8	6
68	P.Hasa	298	122	251	104	38	66	0	208	43
69	P.Hysi	230	113	172	38	27	55	1	121	51
70	R.Kote	308	86	235	48	20	50	3	121	114
71	S.Hysa	294	152	195	41	22	75	3	141	54
72	S.Lule	324	96	288	137	36	52	2	227	61
73	S.Malaj	277	146	117	36	21	57	1	115	2
74	S.Salavaci	281	154	172	36	52	50	1	139	33
75	Sh.Garunja	242	105	163	42	19	65	1	127	36
76	Sh.Kurti	277	131	159	45	31	70	7	153	6

Nr.	Prokurori	Kallezime të marra 2017	Mosfillime	Menyra e Perfundimit					Gjithsej përfunduar	Në hetim total
				Total	Gjyqi	Pushuar	Pezulluar	Kopetenc		
				Proçedim		çeshtje				
77	Sh.Pasha	62	5	59	19	5	8	18	50	9
78	V.Preci	280	117	214	64	39	62	4	169	45
79	Y.Bashaj	271	123	194	44	39	69	0	152	42
80	Y.Pjeternikaj	293	99	278	75	58	69	0	202	76
81	Z.Hoda	106	66	107	25	25	53	4	107	0

TOTALI	17321	7552	12884	3435	1935	4022	228	9620	3264
---------------	--------------	-------------	--------------	-------------	-------------	-------------	------------	-------------	-------------

Analiza e prokurorëve në gjykim 2017

Nr.	Emri PROKURORIT	Nr. Procedimi	Nr. Pandehur	Kerkesa e Prokurorit							Lloji i gjykimit			Vendimi i gjykates						Apelim		
				Burg	Gjob	Kusht	Ore Pune	M.Mjeksor	T.Akt	P.Gjykimi	Zakonsht	Shkurtuar	D.P.D	Burg	Gjob	Kusht	Ore Pune	M.Mjeksor	K.Akt		P.Gjykimi	Pafajsi
1	A.Braho	11	11	4	1	5				1		11		3		7				1		
2	A.Allajbeu	28	29	10	1	16	1			1	2	27		11	1	13	3			1		1
3	A.Cama	57	60	27	7	19				7	4	56		21	7	20	2			7	3	9
4	A.Demirneli	43	53	26	3	16	4			4	7	46		21	6	18	4			4		
5	A.Dyrmishi	110	118	38	9	49	15	1		6	2	116		36	6	49	17	1		7	2	6
6	A.Galanxhi	40	50	37	4	7	1			1	2	48		25	4	11	2			2	6	9
7	A.Gurakuqi	8	8	5		3						8		4		4						
8	A.Kraja	60	63	20	7	16	15			5	1	59		7	9	18	15			5		1
9	A.Lulaj	49	57	29	6	17	3		1	1	3	54		22	9	17	3		1	2	3	9
10	A.Mersini	41	46	24	4	16	2				2	44		21	4	16	4			1		1
11	A.Zifla	103	105	56	2	41	3	1		2	3	101	1	34	10	44	11	1		5		9
12	A.Ndoi	27	30	12	7	6	1	1		3		29	1	10	6	7	3	1		3		2
13	A.Permeti	56	61	29	5	22	2	1		2	3	58		25	4	21	6	1		4		6
14	A.Prifti	1	1			1										1						
15	A.Qilimi	8	10	7		3					3	7		6		2	1				1	3
16	A.Sevdari	12	13	4	3	4	1				5	8		4	3	4	1			1		
17	A.Xhelili	33	35	9	3	18	1			4	3	32		7	4	20				4		2
18	B.Cani	18	18	8	1	6	2	1			2	16		6	1	7	3	1				1
19	B.Mete	36	37	8	6	13	6	1		3	4	33		7	9	8	7	1		4	1	2
20	B.Hoxha	46	57	25	13	11	1	1		6	9	48		19	12	14	2	1		6	3	8
21	B.Maksuti	57	64	23	5	28	2	1		5	1	63		22	4	25	5	1		6	1	3
22	D.Rreshka	8	9	4	2	3					3	6		2	4	3						
23	D.Sulaj	7	7	4	1	1	1					7		3	1	1	1				1	1
24	Sh.Kurti	32	35	18	4	10	1			2	1	34		17	5	11				2		2

Zyra e Statistikave
Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë
Tiranë

Nr.	Emri PROKURORIT	Nr. Procedimi	Nr. Pandehur	Kerkesa e Prokurorit							Lloji I gjykimit			Vendimi i gjykates							Apelimi	
				Burg	Gjob	Kusht	Ore Pune	M.Mjeksor	T.Akt	P.Gjykimi	Zakonsher	Shkurtuar	D.P.D	Burg	Gjob	Kusht	Ore Pune	M.Mjeksor	K.Akt	P.Gjykimi		Pafajsi
25	E.Bregova	58	74	31	6	31	1	1		4	6	68		24	8	26	7	1		5	3	8
26	E.Bala	4	4	1		2		1				4				2	1	1				
27	E.Celami	67	74	27	6	31	4	1		4	5	68	1	19	8	34	6	1		5	1	8
28	E.Karaxha	68	90	43	4	33	7	2		1	5	82	2	44	5	31	6	2		1	1	3
29	E.Gjini	72	80	34	12	26	1			7	8	70	2	30	10	23	8			9		5
30	E.Imeraj	15	20	11	1	4				4	1	19		7	1	6	1			4	1	4
31	E.Kapo	54	66	22	3	32	5	1		3	4	62		22	4	26	8	1		3	2	4
32	E.Miha	17	17	8	2	7						17		5	1	6	5					4
33	G.Qana	62	71	54	3	11	2			1	5	66		40	5	17	4			2	3	8
34	E.Kombi	84	105	43	10	43	1			8	5	100		37	12	43	3			9	1	5
35	Gj.Kodra	62	71	32	12	19	3	1		4	2	66		22	17	20	6	1		5		
36	Gj.Tako	86	112	43	11	25	27	1		4	18	93		23	8	36	21	1		12	11	25
37	H.Mulaj	24	28	15	1	6		1		5		28		14	2	5	1	1		5		
38	J.Xhengo	31	32	6	7	12	5			3	1	31		5	8	12	5			3		2
39	J.Zonja	52	68	26	5	20	12			5	15	52		19	4	21	12			7	5	17
40	M.Bushi	73	76	40		33				3	4	72		17	9	34	10			5	1	4
41	P.Hasa	115	158	97	4	48	2	1		6	13	145		79	5	53	7	1		8	5	12
42	L.Ziguri	31	34	17	1	13				3	2	32		11	1	17	1			3	1	2
43	M.Zaimi	44	45	18	3	18	1	1		4	4	41		14	6	16	3	1		5		1
44	I.Ahmetlli	16	22	4	6	10	2					22		4	7	9	2					1
45	P.Bica	4	4			4						4		1		3						
46	Sh.Pasha	12	12		3	4	5					12			3	4	5					

Zyra e Statistikave
Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë
Tiranë

Nr.	Emri PROKURORIT	Nr. Procedimi	Nr. Pandehur	Kerkesa e Prokurorit							Lloji I gjykimit			Vendimi i gjykates						Apelim		
				Burg	Gjob	Kusht	Ore Pune	M.Mjeksore	T.Akt	P.Gjykimi	Zakonshem	Shkurtuar	D.P.D	Burg	Gjob	Kusht	Ore Pune	M.Mjeksore	K.Akt		P.Gjykimi	Pafajsi
47	D.Nushi	59	61	32	4	13		3		9	8	52	1	33	4	12		3		9		6
48	M.Cano	54	66	33	5	18		3		7	5	60	1	27	4	21	3	3		7	1	9
49	N.Tota	64	67	21	4	34	4	2		2	3	64		19	6	29	7	2		2	2	4
50	E.Mazreku	66	67	38	11	14		2		1	8	59		27	12	14	5	1		4	4	5
51	O.Dado	57	59	32	10	13		1		3	6	53		24	8	20	2	1		3	1	8
52	N.Tavani	27	33	17	8	5	2				7	24	2	14	8	6	2				3	4
53	P.Hysi	41	55	12	8	17	2	1		13	4	51		11	7	19		1		17		4
54	Y.Bashaj	40	44	22	6	11	3	1		1	3	41		18	6	15	3	1		1		1
55	S.Malaj	51	52	23	4	23	1			1	2	50		22	3	22	3			1	1	2
56	R.Kote	11	13	8		4		1				13		8	1	2	1	1				
57	S.Hysa	43	43	14	7	19	1	1		1	3	40		14	6	19	1	1		2		
58	S.Salavaci	29	41	25	2	13				1	8	33		20	3	9	1			4	4	7
59	I.Jata	105	109	14	7	73	14			1	3	106		8	11	70	17			1	2	2
60	Sh.Garunja	38	41	8	3	24	1			5	4	36	1	10	3	22	1			5		
61	S.Lule	122	141	56	10	70	1	1		2	20	121		38	12	77	4	1		3	3	9
62	V.Preci	73	81	52	4	15	2	2		6	7	74		36	3	24	5	2		8	3	11
63	E.Kareci	113	118	25	9	71	8	2		2	2	114		27	10	65	10	2		2	1	4
64	E.Bimi	13	16	11	1	4					3	13		8	1	3	1			1	2	4
65	K.Berberi	65	68	15	3	40	6	1		3		68		15	3	35	11	1		3		1
66	K.Shahu	37	41	14	1	21	2	1		2	2	39		15	1	18	2	1		2	2	2
67	Y.Pjeternikaj	39	43	35	1	6		1			4	39		24	2	11	3	1		1	1	23
68	Z.Hoda	37	38	19	3	15	1			1	2	38		15	4	17	2			1		
TOTALI		3126	3537	1525	305	1286	188	42	1	183	262	3253	12	1203	351	1315	296	41	1	233	86	294

Zyra e Statistikave
Prokuroria pranë gjykatës së shkallës së parë
Tiranë